**VENDIM**
**Nr.536, datë 1.5.2008**

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË BASHKISË DURRËS TË QARKUT TË DURRËSIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të bashkisë Durrës të qarkut të Durrësit, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të kësaj bashkie, sipas lidhjes 1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 257 (dyqind e pesëdhjetë e shtatë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 1840 (një mijë e tetëqind e dyzet).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

Bashkia Durrës
Lidhja nr. 1

| **Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit** | **Fusha e përdorimit të pronës** | **Lloji i transferimit** |
|---|---|---|
| 25,55,56,26-29 | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve administrative | Në pronësi |
| 118,121,125,126,128, 129,130 | Monumente historike e kulturore dhe buste me interes vendor | Në pronësi |
| 137-175,1817,1821,1822 | Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore | Në pronësi |
| 176-215,1823,1824,1835, 1836-1839,1840 | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik | Në pronësi |
| 1803, 1807,1809-1816 | Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik | Në pronësi |
| 127,131,132,133,134,135, 136 | Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social- kulturore e sportive | Në pronësi |
| 733-736 | Prona që përdoren për realizimin e funksioneve sociale | Në pronësi |
| 216-219,226-238,240-732,1825-1831,1832-1834 | Prona që përdoren për strehim dhe mbrojtjen civile | Në pronësi |
| 737-806,814-821,828-869 870- 1059,1819,1820,1 147(vetëm pasuria 5/43) | Infrastrukturë (rrugë vendore, lulishte) dhe shërbime publike | Në pronësi |
| 822-827 | Varrezat publike | Në pronësi |

| | | |
|---|---|---|
| 1060-1146,1147( pa pasurinë 5/43)-1281 | Troje dhe hapësira | Në përdorim |
| 1286,1289,1293-1295, 1374-1377,1378-1398 | Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe ushqimit (kanale të treta, tokë inproduktive dhe objekte të ish-NB-ve) | Në pronësi |
| 1290-1292, 1370-1373 | Prona që përdoren në fushën e bujqesisë dhe ushqimit (tokë produktive) | Në përdorim |